




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR



3945
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 06/10.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Diber Nr. 53

Datë: 01.10.2025 si dhe projekt-vendimin nr.12 Datë 18.09.2025.

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2025 PËR ALOKIM FONDE PËR SHPENZIME KORRENTE PËR AKT-MARRRËVESHJEN ME OBJEKT : ”KRYERJE E PUNIMEVE PËR KOMPLETIMIN E URËS METALIKE TIP BAILEY , MBI LUMIN DRIN , NJËSIA ADMINISTRATIVE MUHURR , BASHKIA DIBËR”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Ilir Elezi

Handwritten signature and date: 06.10.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.882/1 prot.

Peshkopi, më 10.10.2025

Lënda: Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër..

BASHKISË

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.53 (pesëdhjetë e tre) datë 01.10.2025, të Këshillit të Bashkisë Dibër, "Për akordim fondi për akomodim e materiale për forcat ndërhyrëse në infrastrukturë kritike për emergjencat civile ", **vendosa:**

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

PREFEKTI
Nexhbedin **SHEHU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 53 Datë 01/10/2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2025 PËR ALOKIM FONDE PËR SHPENZIME KORRENTE PËR AKT-MARRËVESHJEN ME OBJEKT : “KRYERJE E PUNIMEVE PËR KOMPLETIMIN E URËS METALIKE TIP BAILEY , MBI LUMIN DRIN , NJËSIA ADMINISTRATIVE MUHURR , BASHKIA DIBËR”.

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 03.07.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin „
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore ”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028 ”
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” .
- Ligji nr 45/2019 “Për mbrojtjen civile”
- Vendim nr 414 date 08.07.2021 Per miratimin e procedurave dhe kriterave te ndarjes dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile(ndryshuar me vkm.nr 290 date 17.5.2023)
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”,

Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025”,


Bazuar në akt-marreveshjen e lidhur nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes , Komanda Mbështetëse , Batalioni i Xhenios nr.1430/2 , 09.09.2025 dhe Bashkisë Dibër me nr.3523/1 , date 12.09.2025 , Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **01.10.2025** me 20 vota pro 1 kundër 0 apstenim :

VENDOSI:

Në buxhetin e vitit 2025 të bëhen ndryshimet si më poshte:

1. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e regjistrit të shpenzimeve korrente , për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur)
2. Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2025 (për ndryshimet) sipas tabelës nr 1 bashkelidhur.
3. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Territorit Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall më datë **01.10.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Dibër
Drejtoria Ekonomike
Sektori i financës

PROJEKT-V E N D I M
Nr 12 Datë 18/09/2025

PËR NJË NDRYSHIM NE BUXHETIN E BASHKISE DIBER PËR VITIN 2025 PER ALOKIM FONDE PER SHPENZIME KORRENTE PËR AKT-MARRËVESHJEN ME OBJEKT :

"KRYERJE E PUNIMEVE PËR KOMPLETIMIN E URËS METALIKE TIP BAILEY , MBI LUMIN DRIN , NJËSIA ADMINISTRATIVE MUHURR , BASHKIA DIBËR".

Në mbështetje të:

- Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010 , "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin „
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2026-2028 "
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore " .
- Ligji nr 45/2019 "Per mbrojtjen civile"
- Vendim nr 414 date 08.07.2021 " Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile (ndryshuar me vkm nr. 290, datë 17.5.2023)
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025",

Bazuar në akt-marreveshjen e lidhur nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes , Komanda Mbështetëse , Batalioni i Xhenios nr.1430/2 , 09.09.2025 dhe Bashkisë Dibër me nr.3523/1 , date 12.09.2025

K E R K O J M E :

Në buxhetin e vitit 2025 të bëhen ndryshimet si më poshte:

1. Miratimin e ndryshimeve në tabelën e regjistrit te shpenzimeve korrente , për vitin 2025 (Tabela nr 1 bashkelidhur)
2. Miratimin e strukture buxhetore për vitin 2025 (për ndryshimet) sipas tabelës nr 1 bashkelidhur.
3. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Mbrojtjes dhe Zhvillimit te Territorit Dibër
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Dibër

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejt看 Juridik
Ismet SARACI

Drejt看 Ekonomik
Çeljeta ZUNA

Specialiste Buxheti
Pranvera LAMI


KRYETARI I BASHKISE
Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me porosi
Nënkryetari bashkisë
Lorenc CIBAKUE





TABELA 1

PAKËSCHET						
Pershkrim i fondeve	Grup	Llog		Programi	Vlera	
		Ekonomik	Kapitulli			
1 Fondi i emergjencave	00	606	1	1110	2,169,438	
SHUMA					2,169,438	
SHTOHET						
1 Dieta	00	602	1	1110	990,000	
2 Naftë	00	602	1	6260	214,500	
3 Lubrifikant	00	602	1	6260	22,400	
4 Lende drusore & materiale montimi	00	602	1	6260	900,000	
5 Shpenzime te tjera	00	602	1	6260	42,538	
SHUMA					2,169,438	

Specialiste e Buxhetit
Pranvera LAMI

DREJTOR EKONOMIK
Gjelja ZUNA

Nën Kryetar
Ligjend GIBAKU



RELACION TEKNIK SHPJEGUES

Objekti: Ndërhyrje për rehabilitimin e urës metalike tip “Bailey” në fshatin Muhur

Vendndodhja: Fshati Muhur, Njësia Administrative Muhur, Bashkia Diber

Gjatësia e urës: rreth 150 metra

Lloji i urës: Ura metalike tip “Bailey”

1. Gjendja ekzistuese

Ura metalike e tipit “Bailey” e vendosur mbi lumin Drin në fshatin Muhur përbën një nga pikat kryesore të lidhjes rrugore për komunitetin lokal, duke shërbyer për lidhjen e fshatrave përreth me rrugët kryesore dhe me qendrën e njësisë administrative. Kjo urë ka një gjatësi konstruktive rreth 150 metra dhe është ndërtuar disa dekada më parë, si një strukturë e përkohshme me elementë metalikë modulare, të montuar në vend.

Aktualisht, ura ndodhet në një gjendje të **amortizuar të konsiderueshme**, për shkak të kalimit të gjatë kohor, mungesës së mirëmbajtjes periodike dhe kushteve atmosferike të zonës. Gjatë inspektimeve në terren janë evidentuar dëmtime të dukshme në disa elementë konstruktivë dhe ndihmës të saj, si më poshtë:

- **Elementët mbajtës metalikë** (traversat dhe panelet anësore të tipit Bailey) paraqesin korrozion të përhapur, humbje të shtresës mbrojtëse dhe në disa raste edhe deformime lokale.
- **Pillakat e shkeljes** (tabllotë metalike të kalimit) janë të dëmtuara, të konsumuara në shumë zona dhe paraqesin rrezik për qarkullimin e mjeteve.
- **Përforcimet horizontale dhe diagonale** në ndërtimin e urës kanë disa lidhje të liruara ose të dëmtuara, duke ndikuar në qëndrueshmërinë e përgjithshme të strukturës.
- **Elementët e mbajtjes në themel** (mbështetëset dhe skelat metalike) paraqesin dëmtime të avancuara nga korrozioni dhe nga veprimi i ujërave, veçanërisht në zonat e kontaktit me lumin.
- Nuk ekzistojnë sinjalistika dhe elementë mbrojtës të përshtatshëm për sigurinë rrugore.

2. Nevoja për ndërhyrje

Duke qenë se ura është një nyje e rëndësishme infrastrukturore për lëvizjen e banorëve, mjeteve të transportit, mjeteve të emergjencës dhe shërbimeve publike, gjendja aktuale e saj paraqet **rrezik real për sigurinë publike dhe vazhdimësinë e komunikimit rrugor**. Kjo gjendje e amortizuar kërkon ndërhyrje të menjëhershme në mënyrë që të.

- Garantohet qëndrueshmëria strukturore dhe jetëgjatësia e urës;
- Përmirësohet siguria në qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve;
- Parandalohen dëmtime të mëtejshme që do të kërkonin kosto edhe më të larta në të ardhmen;
- Ruhet funksioni strategjik i urës si lidhje kryesore për zonën.

3. Përmbajtja e ndërhyrjes së propozuar

Ndërhyrjet teknike të parashikuara përfshijnë:

- Pastrim të plotë të strukturës metalike nga korrozioni dhe aplikim i shtresave të reja mbrojtëse antikorrozive;
- Ndërrim i elementëve të dëmtuar mbajtës dhe të lidhjeve të paneleve anësore;
- Zëvendësim i pllakave metalike të shkeljes me elementë të rinj, sipas standardeve aktuale të ngarkesave rrugore;
- Forcim i lidhjeve horizontale dhe diagonale për rritjen e qëndrueshmërisë së strukturës;
- Konsolidim i mbështetëseve dhe riparime në zonat e themelimit në kontakt me lumin;
- Vendosje e sinjalistikës rrugore dhe mbrojtëseve anësore për rritjen e sigurisë në qarkullim.

4. Përfundim

Në përfundim, duke marrë në konsideratë gjendjen e amortizuar të urës metalike tip "Bailey" në fshatin Muhur, rëndësinë strategjike të saj për komunitetin lokal dhe nevojën urgjente për garantimin e sigurisë së përdoruesve, **proponohet që Këshilli Bashkiak të miratojë ndërhyrjen rehabilituese në këtë objekt infrastrukture.** Kjo ndërhyrje do të sigurojë që ura të vazhdojë të jetë funksionale për një periudhë afatgjatë, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë dhe sigurinë e shërbimit publik që ajo ofron.

Punoi: Elvis MANGA



TABELA 1

PAKËSCHET					
Pershkrim i fondeve	Grup	Llog Ekrn	Kapitulli	Programi	Vlera
1 Fondi i emergjencave	00	606	1	1110	2,169,438
SHUMA					2,169,438
SHTOHET					
1 Dieta	00	602	1	1110	990,000
2 Naftë	00	602	1	6260	214,500
3 Lubrifikant	00	602	1	6260	22,400
4 Lende drusore & materiale montimi	00	602	1	6260	900,000
5 Shpenzime te tjera	00	602	1	6260	42,538
SHUMA					2,169,438

Specialiste e Buxhetit
Pranvera LAMI

DREJTOR EKONOMIK
Çeljeta ZUNA

